



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.170/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 26.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa Anr.170/2025 e datës 24.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.
- II. Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 5,000.00 (pesëmijë) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi

A r s y e t i m

Me datë 24.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se më datë 23 janar 2025, kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Albena Reshitaj, ka publikuar një foto në rrjetin social Facebook, në një nga tubimet e mbajtura të Lëvizjes Vetëvendosje, në të cilën foto, në qendër të saj shihet një parullë e vendosur nga simpatizantët dhe mbështetësit e Lëvizjes Vetëvendosje me përmbajtjen "*PROKURORIA E KOSOVËS E KAPUR NGA HAJNAT QEVERIA KURTI I QOI NË GJYKATA 250 LËNDË O DEMME TË GJITHË NË KOSOVË MË 09.02.2025 VOTOJNA 118 ATDHEU NË RREZIK MERGATA VOTON LVV*", gjuhë e cila përbën nxitje,

urrejtje, ofendim, denigrim dhe njëherit shprehë ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese për partitë kundërshtarë të Lëvizjes Vetëvendosje.

Provë: Postimi i publikuar në profilin e Albena Reshitaj në rrjetin social Facebook; <https://www.facebook.com/albenareshitajofficial/posts/pfbid02S8gëvcPGuoXB9RryStHCLedZHrf>

7tNpX5 Ixë7JUZUF861 FMjuëHPI<4XLZFgjBtzdl

Shpërndarja e një postimi të tillë, ku në qendër të kësaj foto shihet haptazi parulla me përmbajtje përçmuese, urrejtëse, denigruese dhe ofenduese nga kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje Albena Reshitaj, përbën shkelje të rregullave zgjedhore, mbi të cilat duhet të organizohet dhe të zhvillohet fushata zgjedhore.

Më tej thuhet se postimi i kandidates për deputete Albena Reshitaj, vazhdon të jetë aktiv në profilin e së njëjtës edhe në kohën e parashtrimit të kësaj ankesë dhe se PDK ka parashtruar ankesë edhe më herët në lidhje me veprimet e kandidates për deputete Albena Reshitaj. Më datë 17.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 26.01.2025, Lëvizja VETËVENDOSJE! Vlerëson se ankesa e tillë, është e pabazuar. Kjo për faktin se e njëjta në asnjë moment, nuk përmban ndonjë fakt i cili do ta ndërlidhte veprimin e pretenduar si shkelje të kandidates, me subjektin ankimues, dhe e cila, do të binte ndesh me nenin 34 të LZP-së, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11.

Përveç tjerash, tubimi është mbajtur në Cyrih të Zvicrës dhe kandidatja në fjalë, ka postuar vetëm një fotografi të tubimit përkatës i cili është mbajtur në Cyrih. Gjithashtu, përderisa në njërin anë, parulla që është mbajtur në duart e pjesëmarrësve të tubimit, ka qenë parullë e cila është publikuar në Cyrih, në anën tjetër, e njëjta, nuk ka asgjë të bëjë me subjektin përkatës ankimues, në këtë rast PDK-në.

Kësisoj subjektin nuk i janë shkelur asnjë e drejtë lidhur me kodin e mirësjelljes së subjekteve politike.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

Ankesa është e bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LVV vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik PDK, janë të bazuara dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 pika l.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisi si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”. Njëherit subjekti politikë në fjalë përmes përgjigjes në ankesë nuk ka mohuar që në këtë tubim kanë përdorë foton me pano që përmban shënimin, për të cilin subjekti ankues pretendon se nxit urrejtje në kohë të fushatës zgjedhore.

Sipas Panelit paraqitja e fotos me këtë përmbajtje *PROKURORIA E KOSOVËS E KAPUR NGA HAJNAT QEVERIA KURTI I QOI NË GJYKATA 250 LËNDË O DEMME TË GJITHË NË KOSOVË MË 09.02.2025 VOTOJNA 118 ATDHEU NË RREZIK MERGATA VOTON LVV*", nga ana e kandidatës së subjektit politik LVV, konsiderohet se është përdorë gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt të tjerëve në kuadër të fushatës zgjedhore dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe në përgjithësi atmosfere destabiliteti. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të nderhme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materialit tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*. Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politik në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë e për të cilat shkelje paneli ka shqiptuar dënime me gjobë..

Përveç të cekurave më lartë, Paneli me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore

si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.170/2025 më datë 26.01.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.